

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Në vitin 2016 140 deputetë të të gjitha forcave politike në këtë sallë votuan njëzëri ndryshimet kushtetuese, të cilat i hapën rrugë një reforme rrënjësore në sistemin e drejtësisë, duke aspiruar drejtësi pa ndikime politike apo korruptive, drejtësi të pavarur, të paanshme, efektive dhe eficiente për të gjithë; drejtësi që i vë përpara përgjegjësisë zyrtarët që abuzojnë me pushtetin; drejtësi që godet ashpër krimin dhe krimin e organizuar; drejtësi tek e cila qytetarët duhet të kenë besim. Kjo reformë u bë guri i themelit për konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe prosperitetin e vendit tonë, si motori më i fuqishëm që e çon Shqipërinë drejt Bashkimit Europian. Sot, pas më shumë se 5 vjetësh, mes të gjitha sfidave dhe problematikave që janë hasur qoftë në hartim, në miratim apo në zbatim, ne jemi duke dëshmuar jetësimin e reformës në drejtësi. Janë ngritur dhe ushtruar funksionet e tyre rregullisht të gjitha organet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme kundër Krimin dhe Krimin të Organizuar, Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Shkolla e Magjistraturës me një intensifikim të shkëlqyer të punës së saj për të krijuar brezin e ri të magjistratëve profesionistë dhe me integritet të lartë etiko-moral. Prej më shumë se 1 viti Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë janë funksionale, pas një periudhe pauze në veprimtarinë gjyqësore, si rrjedhojë e vakancave të krijuara nga dorëheqjet dhe nga procesi i rivlerësimit. Të dyja këto gjykata kanë punuar me ritme të kënaqshme, duke konsideruar ngarkesat që kanë pasur si rrjedhojë e akumulimit të çështjeve të mbartura. Pavarësisht vështirësive që sollën në planin financiar, por edhe menaxherial dy fatkeqësi të njëpasnjëshme, tërmeti dhe pandemia, çdo vit në këtë sallë janë miratuar buxhete në rritje dhe shtesa në strukturat e organeve të drejtësisë që mundësojnë ushtrimin sa më mirë të funksioneve nga ana e tyre.

Sot sfidat e drejtësisë janë në drejtim të rritjes së eficiencës në gjykata dhe në prokurori, pavarësisht së magjistratëve, intensifikimit të rezultateve të pritshme dhe rikthimit të besimit të publikut te drejtësia. Nëse bëjmë një analizë, vite më parë edhe vendimmarrjet tona kishin si qëllim funksionalitetin sa më të shpejtë. Ndërsa sot puna e kryer më parë nuk na kushtëzon më me faktorin kohë, gjë që na jep mundësinë të mendojmë të gjithë më shumë cilësisht e të bëjmë vlerësime më të plota jo vetëm se çfarë mund të përmirësohet, kur konstatohen probleme gjatë zbatimit të reformës, por edhe se si t'i konsolidojmë standardet më të mira në zbatimin e ligjeve në interes të qytetarëve dhe drejtësisë që qytetarët presin. Ky është një tregues i rëndësishëm i ecurisë së zbatimit të reformës.

Të gjitha sa thashë në lidhje me reformën në drejtësi nuk do të kishin rëndësinë e duhur pa atë që të gjithë e njohin si vetingu i drejtësisë, apo në gjuhën e ligjit si rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe i prokurorëve. Vetingu është një prej qëllimeve kryesore dhe shtylla e reformës në drejtësi për të krijuar një trupë gjyqtarësh dhe prokurorësh me integritet të lartë etiko-moral dhe profesional për të garantuar pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e sistemit. Vetingu parashikohet në dispozitat kushtetuese dhe ligjore; përbën një masë të jashtëzakonshme dhe tranzitore, por të nevojshme për drejtësinë e pavarur dhe efektive. Vetingu

është element thelbësor për të garantuar një nivel të dukshëm integriteti të magjistratëve, themel ky për besimin e publikut në veprimtarinë e drejtësisë. Bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit të Venecias në atë kohë, procesi i vetingut u parashikua në Kushtetutë si një sistem i kualifikuar, i pavarur, i paanshëm, ad hoc, me funksion rivlerësimin e njohurive profesionale, integritetin moral, etik dhe psikologjik të gjyqtarëve e prokurorëve, i kombinuar ky me një verifikim të posaçëm të pasurisë së tyre, ku barra e provës u lihej subjekteve të verifikuara, duke ofruar të gjitha garancitë e nevojshme për një proces të rregullt dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtën e një ankimi efektiv. Sistemi i vetingut për vlerësimin e mbi 800 subjekteve gjyqtarë, prokurorë, ndihmësligjorë e të tjerë kryhet nga tri organe aktualisht. Konkretisht, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, organ administrativ që shërben si shkallë e parë rivlerësimi; Komisioneri Publik, që përfaqëson interesin publik dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur, si dhe Kolegji i Pavarur i Apelit, si një dhomë pranë Gjykatës Kushtetuese, që shqyrton ankimet e subjekteve të rivlerësimit.

Si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si komisionerët publikë kanë një mandat 5-vjeçar nga data e fillimit të funksionimit të tyre. Ky mandat përfundon në qershor të këtij viti, pra të vitit 2022. Dispozitat kushtetuese, ato që janë në fuqi, parashikojnë zgjidhje për rastet kur organet e vetingut nuk do t'i përmbyllnin dot çështjet e rivlerësimit me mbarimin e mandatit të tyre. Konkretisht, çështjet, të cilat do të mbeteshin dhe do të mbeten pa shqyrtuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, do t'i kalonin Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjyqtarët, Këshillit të Lartë të Prokurorisë për prokurorët, ndërsa kompetencat e komisionerëve publik do t'i kalonin SPAK-ut. Këtë skenar parashikon sot Kushtetuta në fuqi. Ndërsa për ankimet kundër Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që do të ishin ende të papërfunduara, në përfundim të këtij procesi do të shqyrtoheshin nga Gjykata Kushtetuese kur Kolegjit të Apelit t'i mbarojë mandati i tij, i cili është 9-vjeçar dhe është ende në kohë. Pra, këtë vit nuk mbaron afati i Kolegjit të Apelit, por mbaron afati i komisionarëve publikë dhe ai i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Aktualisht, dy organe, KPK-ja dhe komisionerët publikë, kanë shqyrtuar rreth 60% të çështjeve.

Në përfundim të mandatit të tyre, sipas të gjitha analizave, rezulton se do të mbeten të pashqyrtuara mbi 300 çështje. Shkaqet, që kanë sjellë mospërmbushjen e çështjeve brenda këtij mandati 5-vjeçar, pra brenda qershorit të vitit 2022, siç janë bërë publike gjatë shqyrtimit të nismës në Komisionin e Ligjeve me Këshillin e Legjislacionit, sepse seancat kanë qenë të hapura për publikun online dhe janë transmetuar direkt në televizion, janë: sfidat e krijimit të institucioneve, të cilat, pa diskutim, kanë ndikuar në ecurinë e punës, me qëllim përmbylljen e të gjithë procesit brenda qershorit 2022; krijimi i bazës rregullatore për kryerjen e funksioneve; konsolidimi i një praktike që varej edhe nga bashkëpunimi me institucione të tjera për hetime administrative, si DSIK-ja dhe ILDKP-ja, që duhet të çojnë raporte në kuadër të procesit të vetingut, në mënyrë që organet e vetingut të jenë në gjendje të bëjnë një vlerësim dhe të marrin vendimet përkatëse; pa diskutim, pandemia e COVID-it, e cila paralelizoi jetën në të gjithë sektorët dhe në shoqërinë tonë ndikoi edhe në vonesat në procesin e vetingut. Këto vonesa, të cilat unë i përmenda, janë konsideruar të justifikuara nga Komisioni i Venecias në opinionin e dhjetorit të vitit 2021, në të cilin nisma për zgjatjen e mandatit të vetingut u rekomandua në përputhje me standardet europiane. Bazuar në analizat gjatë shqyrtimit të nismës për ndryshime kushtetuese, nisur nga koha mesatare që merr një proces rivlerësimi në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, rezulton se përmbyllja e të gjitha çështjeve nga organet aktuale të rivlerësimit kërkon rreth 2 vjet e gjysmë kohë, ose deri në datën 31.12.2024. Pra, kërkohet një kohë tej mandatit të tyre kushtetues, sipas parashikimeve aktuale në fuqi.

Ne sot jemi para situatës, ku duhet të vendosim të shtyjmë afatin e këtyre organeve, siç propozohet në projektligjin që pret të votohet nga ne apo të vijojmë me skenarin që parashikon Kushtetuta, ku

mbi 300 çështje të papërfunduara do t'i kalojnë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe kompetencat e komisionerëve publik t'i kalojnë SPAK-ut. Në fakt, kjo është përgjegjësia që ne sot duam të tregojmë apo të marrim përsipër. Duhet të vlerësojmë me maturi dhe përgjegjshmëri se cili skenar i përmbush më së miri qëllimet e reformës në drejtësi, atë që dakordësuan 140 deputetë në këtë sallë në vitin 2016, deputetë që përfaqësonin të gjithë klasën politike shqiptare në Kuvend. Për të bërë një vlerësim të saktë dhe të drejtë na vijnë në ndihmë opinionet e ekspertëve konstitucionalistë, dëgjesat publike me grupet e interesit, me shoqërinë civile, me botën akademike dhe me institucionet ndërkombëtare, opinionit i Komisionit të Venecias, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i misionit të OPDA-it, i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të Komisionit European, diskutimet e vjera të kolegëve tanë gjatë shqyrtimit të nismës në mbledhjet e përbashkëta të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve.

Dua t'i falënderoj të gjithë pa përjashtim për kontributin e tyre që sot na mundësojnë një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar. Nisma për zgjatjen e mandatit dhe organeve të vetingut është propozuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, Komisioni European i Bashkimit European. Është mbështetur gjerësisht nga partnerët ndërkombëtarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi European, e vijnë ta mbështesin dhe ta asistojnë Shqipërinë në reformën e sistemit të drejtësisë, por edhe nga të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtarë në vendin tonë. Është e vërtetë që Partia Socialiste mori nismën për ndryshime kushtetuese, sepse ne besojmë te kjo nismë, por kjo nuk është një çështje që i takon vetëm maxhorancës, por i shërben vetëm interesit të përgjithshëm të popullit shqiptar; është një çështje për drejtësinë që presin qytetarët dhe për të ardhmen e vendit në familjen europiane. Nga të gjitha kontributet dhe analizat që kemi marrë në shqyrtim rezultojnë se propozimi për të zgatur mandatin e organeve të vetingut deri më 31 dhjetor 2024 duhet miratuar sot, pasi vjen në përputhje me qëllimet dhe me vullnetin e kushtetutëbërësit për ndryshimet e vitit 2016, të cilat i hapën rrugë një reforme të thellë dhe gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë. Në fakt, propozimi konsiston në shtyrjen e afatit që nuk prek thelbin e procesit të vetingut dhe as standardet që kërkohen prej një procesi të tillë. Kjo do të thotë se thelbi i dispozitës kalimtare kushtetuese nuk ndryshon, është vetëm një menaxher i mirë i kohës dhe i përfundimit të vlerësimit kalimtar nga të njëjtat organe që edhe e nisën atë.

Ky amendament rregullues është i nevojshëm. Ajo çka ka ndryshuar sot, në raport me atë që hartuesit e Kushtetutës dhe ata që e miratuan parashikuan, është fakti se kanë mbetur pa e u rivlerësuar rreth 1/3 e subjekteve ose mbi 300 çështje. Ndërkohë, ky kalim ishte parashikuar që të ndodhte nëse do të mbetej një numër i vogël subjektësh, për të cilat nuk kishte përfunduar procesi. Projekti i paraqitur krijon mundësinë që koha të shfrytëzohet në favor të shpejtësisë së rivlerësimit, me qëllim që të përfundojnë sa më parë ky proces, ashtu sikurse standardet kushtetuese dhe ato ndërkombëtare e kërkojnë. Ky amendament është në përputhje me standardet europiane, pasi bazohet në arsye objektive, garanton sigurinë juridike, garanton parimin e trajtimit të barabartë, ruan konsistencën dhe integritetin e një procesi në interes të drejtësisë së pavarur dhe efeciente në drejtimit të publikut; propozon një afat të ri, i cili konsiderohet i përshtatshëm nga vetë organet e vetingut dhe nga të gjithë ekspertët që kanë dhënë mendime në lidhje me këtë afat, vjen në përputhje me jurisprudencën kushtetuese dhe standardet europiane për norma me masa të jashtëzakonshme dhe përkohshme, siç është edhe procesi i vetingut.

Ky amendament krijon vazhdimësi dhe siguron mosndryshim të standardeve të procesit. Nuk ka nevojë për procese riorganizuese shtesë dhe nuk do të sjellë kosto apo kohë shtesë. Ai garanton standarde të njësuara të procesit dhe të shqyrtimit të vendimmarrjes për secilin prej subjekteve të rivlerësimit; garanton respektimin e standardeve të vendosura deri më tani nga organet e vetingut dhe janë konfirmuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për çështjet që janë marrë në

shqyrtim dhe kanë vendimmarrje; mban në kontroll të rreptë kohëzgjatjen e procesit, garanton përkohshmërinë e tyre; garanton vazhdimësinë e mbështetjes së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit sipas një praktike dhe përvoje të fituar tashmë. Amendamenti është e vetmja rrugë që sjell një garanci kushtetuese, me qëllim që organe atipike, si organet e vetingut, të mbahen rreptësisht në mbikëqyrje për ushtrimin e përkohshëm të veprimtarisë së tyre, sipas standardeve që kërkon Kushtetuta. Zgjatja e mandatit në këtë rast lidhet ngushtësisht me karakterin funksional të institucionit dhe shërben për përfundimin e detyrës së tij funksionale.

Të nderuar kolegë, pas të gjitha interpretimeve, analizave, studimeve dhe argumenteve që janë përmbledhur gjerësisht në raportin e mbledhjes së përbashkët e Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve, të cilin u përpoqa ta përmbledhë shkurtimisht, sepse ju e keni marrë dhe e keni lexuar atë, rezulton se të gjitha argumentet konfirmojnë se zgjidhja më optimale për të përmbyllur me sukses procesin e vetingut është zgjatja e mandatit të KPK-së dhe komisionerëve publikë deri më 31.12.2024 . Në lidhje me një shqetësim të disa kolegëve, i cili nuk do të konsiderohet i gabuar, se Kushtetuta duhet të jetë një ligj i qëndrueshëm dhe nuk mund t'u nënshtrohet ndryshimeve të shpeshta, mendoj se në rastin konkret ka një justifikim të arsyeshëm. Së pari, çështja e zgjatjes së organeve të vetingut nuk bëhet dot me ligj, por duhet të bëhet me Kushtetutë, sepse atje është i parashikuar. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, atë që nuk ka dashur kushtetutëbërësi ta bëjë me ligj, nuk mund ta bëjmë përveçse në Kushtetutë. Së dyti, amendamenti është me karakter teknik dhe është i nevojshëm. Së treti, amendamenti që paraqitet, është një ndryshim me dispozita kalimtare të Kushtetutës. E them më thjeshtë: ndryshimi që propozohet sot, është ndryshim në një nen që ka një afat. Ai bie vetë nga fuqia në momentin që mbaron afati, kështu që ne nuk duhet t'i kthehemi më kësaj dispozite, përveçse me amendamentin e sotëm. Është një amendament, që, siç e kanë konsideruar edhe ekspertët, që lidhet me një masë të zakonshme për mirëmbajtjen e shtëpisë, pra nuk hyn në thelb të qëllimit të reformës në drejtësi përveçse e lejon atë të vijojë rrugën drejt përmbylljes dhe arritjes së rezultateve.

Gjatë shqyrtimit të nismës kam vënë re se janë shprehur edhe disa rezerva për ecurinë e procesit të vetingut. Unë nuk i paragjykoj kolegët, qofshin arsye objektive apo subjektive, gjithsekush ka mendimin e tij, por sot, në respektim të organeve të vetingut, pavarësisht natyrave të çfarëdolloj apo qëllimeve të ndryshme, ne duhet ta kapërcejmë gjykimin e ngushtë, të vendosim për interesin madhor për vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi, konkretisht për mbylljen e procesit të vetingut, sipas qëllimit që të gjithë bashkë ramë dakord këtu në vitin 2016, duke respektuar në këtë mënyrë që në këtë proces të garantohet parimi i trajtimit të barabartë dhe të garantohet konsistenca e procesit. Kjo jo vetëm që do të lejojë vetingun të arrijë synimet e reformës për një trupë magjistratësh dhe prokurorësh të pavarur, profesionistë dhe me integritet të lartë etiko-moral, por në të njëjtën kohë do t'i lejojë organet e drejtësisë, si Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por edhe SPAK-un që të vijojnë normalisht punët e tyre të përditshme, thelbin e veprimtarisë parësore të tyre. Në fakt, sot në sytë e publikut shikohen si institucionet që pritet të kenë rezultatet që drejtësia dhe qytetarët kërkojnë. Prandaj, ne nuk duhet t'i mbingarkojmë ata me një proces tjetër sui generis, delikat, siç është vetingu, i cili tashmë e ka rrugën dhe standardet e tij. Na duhet thjesht t'i japim më shumë kohë për ta përmbyllur këtë punë. Këtu nuk duhet të harrojmë që, si SPAK-u, ashtu edhe këshillat, janë organe të reja drejt konsolidimit.

Ndaj nuk është momenti i duhur për funksione shtesë, duke pasur në konsideratë edhe faktin që janë mbi 300 çështje që mund t'u kalojnë atyre për shqyrtim, pra ka një ngarkesë, e cila dukshëm do ta pengojë punën e tyre në përmbushje të qëllimeve parësore si institucione. Unë besoj se, pavarësisht rezervave që mund të ketë gjithsecili në bindjen e tij, të gjithë e duan reformën në drejtësi, të gjithë duan që të shikojnë rezultate prej saj dhe kanë arritur në konkluzionin se propozimi për shtyrjen e

mandatit të organeve të vetingut është i duhuri, është në përputhje me Kushtetutën dhe u shërben interesave të drejtësisë dhe është në interes të qytetarëve. Mendoj se koha do ta tregojë se kemi marrë vendimin e duhur. Sot duhen kapërcyer barrierat personale dhe të votohet ky propozim. Në përfundim kam edhe një mesazh për organet e vetingut, duke respektuar pavarësinë e tyre. Ndërsa ne të gjithë besoj se i vlerësojmë ritmet e reja të punës së anëtarëve, i nxitim ata të vijojnë realizimin e detyrës me korrektësi, me profesionalizëm dhe me integritet, pa cenuar procesin, ne i nxitim këto organe për ta përshpejtuar procesin e vetingut për subjektet e mbetura deri në përfundimin e plotë të tij, brenda afateve të reja të propozuara deri më 31 dhjetor 2024. Duke ju falënderuar për vëmendjen, ju ftoj të merrni përgjegjësinë e duhur sot të gjithë dhe ta votoni këtë amendament kushtetues. Faleminderit!